



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2363/Prot.
1

Tiranë, më 01/11 /2022

VENDIM

Nr. 18, datë 01.11.2022

PËR

DHËNIE MENDIMI BORDIT TË ADMINISTRIMIT PËR NIVELIN E PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, Vendimin Nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 268, datë 29.03.2017 dhe Vendimin Nr. 647, datë 05.10.2022 të Këshillit të Ministrave, Vendimin Nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 9, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit Nr. 2363 Prot., datë 24.10.2022, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Dhënien e mendimit Bordit të Administrimit, për miratimin e nivelit të pagave të personelit akademik në Universitetin Politeknik të Tiranës, në kufirin maksimal të përcaktuar për funksion/titull sipas Vendimit Nr. 647, datë 05.10.2022 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 748 datë, 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, kolona 3, lidhja 1.
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maligari

